



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr prot. 06-24348/2025

Datë: 06.08/2025

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) dhe nenin 17 paragrafi 1. shkronja (b) të Ligjit Nr. 03/L -040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1.2, pika 1.2.1, nenit 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1 dhe pika 1.2.2, nenin 10 paragrafi 2 pika 2.2, nënpika 2.2.1, nenin 11 dhe nenit 15 të ligjit nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.30/2013"), Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr.08/2017 për normat teknike të Planifikimit Hapësinorë, Vendimit për dhënien e Pëlqimit për miratim të Planit Zhvillimor Komunal të Klinës 2025-2033 me Nr.Protokoli 5014-2/25 i datës 29.07.2025 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, nenit 10 pika 4 të Statutit të Komunës së Klinës me nr. 01-110-1232/2010 i datës 04.04.2010, Kuvendi i Komunës së Klinës, në mbledhjen VII-të të mbajtur me datë 31.07.2025, merr këtë:

VENDIM

Për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2025-2033

1. MIRATOHET Plani Zhvillimor Komunal për komunën e Klinës për periudhën 8(tetë) vjeçare 2025-2033 (në tekstin e mëtejme (PZHK), si një dokument-Plan multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor duke përfshirë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për tërë territorin e Komunës së Klinës me sipërfaqe prej **308.8 km²**
2. Plani Zhvillimor Komunal i Klinës 2025-2033 përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tërë territorin e Komunës, mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Klinës.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është "Plani Zhvillimor Komunal i Klinës 2025-2033" i hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Klinës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinorë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.30/2013"), Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe

monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinorë dhe Vendimit për dhënien e pëlqimit për miratim të Planit Zhvillimor Komunal të Klinës 2025-2033 me Nr.Protokolit 5014-2/25 i datës 29.07.2025, nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës në Prishtinë.

4. "Plani Zhvillimor Komunal i Klinës 2025-2033" përmban pjesën tekstuale dhe pjesën grafike, Vendimin për Pëlqim Mjedisorë për Raportin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Klinës me Nr.Protokoli 3351/2 i datës 13.12.2024, si dhe Raportin e shqyrtimit publik nga Komisioni komunal, që janë pjesë përbërëse të këtij Vendimi.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen të gjitha organet e Komunës së Klinës, të cilat janë nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës, vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, dhe 7 ditë pas shpalljes në ueb faqen zyrtare të Komunës së Klinës.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2014-2021.

Me këtë vendim njoftohen:

- **MAPL;**
- **Kryetari i Komunes;**
- **Drejtoret e Drejtorive në Komunën e Klinës;**
- **Zyra për Informim;**
- **Arkivi.**

